

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.đ.

Nr. 553 Dt. 23 03 15  
PRISHTINE-A



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.đ.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.Đ.

**Për: Ymer Fejzullahu**  
Udhëheqës i Departamentit  
për tarifave e çmime  
Zyra e Rregullatorit për  
Energji  
Rr."Dervish Rrozhaja" nr.  
Prishtinë

**Kujtim Hoxha**  
Drejtor për Çështje Rregullative  
Korporata Energjetike e Kosovës  
Sh.a.  
Sheshi Nënë Tereza nr.36  
Prishtinë 10000,  
Republika e Kosovës  
[www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)

**Datë: 23.03.2015**

**Tema: Komentet e KEK-ut lidhur në Raportin Vlerësues për të hyrat e lejuara për vitin e tretë relevant – 2015**

I nderuari Z. Fejzullahu,

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) falënderon ZRrE-në për nxjerrjen e Raportit konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) dhe Ngarkesat e Gjeneratorit të Rregulluar për KEK Gjenerimin për vitin relevant 2015.

Pjesa më e madhe çështjeve kyçe, komenteve dhe analizave i kemi shkëmbyer dhe harmonizuar së bashku me ZRrE-në përgjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit për përshtatjet e rregullta vjetore për vitin e tretë relevant.

KEK-u gjatë analizimit dhe vlerësimit të raportit konsultativ (shqyrtimi i Nëntë i Tarifave të Energjisë Elektrike) ka konstatuar se ZRrE i ka përjashtuar disa çështje të cilat kanë qenë të propozuara nga KEK-u për përshtatjet e nevojshme për vitin e tretë relevant, e që ZRrE nuk i ka marrë për bazë.

Çështjet të cilat nuk janë marr për bazë nga ZRrE, ndërsa KEK-u konsideron se duhet të merren për bazë, janë paraqitur në dokumentin e bashkangjitur së bashku me këtë shkresë.

Ne jemi të përkushtuar që të ju ofrojmë të gjitha informatat relevante që mund të japin një kontribut në vendimin përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale për Gjeneratorin Publik.

Me respekt,

**Kujtim Hoxha**

Drejtor për Çështje Rregullative





KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

**KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES Sh. A.**

**Komentet e KEK-ut lidhur në Raportin Vlerësues për të hyrat e lejuara  
për vitin e tretë relevant – 2015**

**Mars, 2015**

## Përmbajtja

1. Hyrje .....	3
3.1.1 Faktori i aplikueshëm i efikasitetit .....	4
3.4 Qasja e ZRrE-së në përshtatjen e kostovo të bartshme për shkak të ngjarjes së Jashtëzakonshme .....	5
3.9 MAR e Gjeneratorit të Rregulluar – Përmbledhje .....	6
4 Ngarkesat e Gjeneratorit të Rregulluar .....	6
6.2 Rregullimi sekondar .....	7

## 1. Hyrje

Korporata Energjetike e Kosovës me datën 09 mars 2015 ka pranuar Raportin Vlerësues lidhur me të hyrat e lejuara maksimale për Gjeneratorin Publik për vitin 2015 në kuadër të SHTE9.

KEK falënderon ZRrE-në për publikimin e Raportit vlerësues për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) dhe Ngarkesat e Gjeneratorit të Rregulluar për KEK Gjenerimin për vitin relevant 2015.

Pas analizimit të Raportit Vlerësues, KEK pajtohet me ZRrE-në në shumicën e çështjeve të ngritura në këtë raport, mirëpo për disa çështje të tjera të cilat janë të rëndësishme e që nuk pajtohet me qëndrimet e ZRrE-së, KEK i ka paraqitur komentete e veta në mënyrë që ZRrE-ja para se të marrë vendimin përfundimtar ti merr në konsideratë këto shqetësime.

Edhe pse pjesën më të madhe të çështjeve kyçe, komenteve dhe analizave i kemi shkëmbyer dhe harmonizuar së bashku me ZRrE-në përgjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit për përshtatjet e rregullta vjetore për vitin e tretë relevant.

KEK-u gjatë analizimit dhe vlerësimit të raportit konsultativ (shqyrtimi i Nëntë i Tarifave të Energjisë Elektrike) ka konstatuar se ZRrE i ka përjashtuar disa çështje të cilat kanë qenë të propozuara nga KEK-u për përshtatjet e nevojshme për vitin e tretë relevant, e që ZRrE nuk i ka marrë për bazë.

Çështjet të cilat nuk janë marr për bazë nga ZRrE, ndërsa KEK-u konsideron se duhet të merren për bazë, janë paraqitur më poshtë:



### 3.1.1 Faktori i aplikueshëm i efikasitetit

KEK-u ka shprehur brengen edhe më herët se faktori i efikasitetit i caktuar nga ZRRE është i paarritshëm, pasi që njësitë në operim (sidomos të TC Kosova A) janë në operim një kohë të gjatë (mbi 40 vite, njësitë e termocentralit Kosova A, ndërsa 30 vite të TC Kosova B). Faktori i efikasitetit është i lidhur me investimet të cilat e përmirësojnë gjendjen e tanishme, si dhe me një kontroll më të mirë të komponentëve që i nënshtrohen faktorit të efikasitetit.

KEK e përsërit pozicionin e vet duke e shprehur brengën se faktori i efikasitetit i caktuar nga ZRRE është vështirë i arritshëm madje edhe në rrethana tërësisht komerciale. Përderisa mekanizmi i rregullimit të çmimeve është i bazuar në idenë e uljes së shpenzimeve për të realizuar profit duke rritur kështu efikasitetin operativ, ky mekanizëm funksionon nën supozimin se ndërmarrja e Rregulluar ka mundësi të kontrollojë të gjitha kostot që i nënshtrohen faktorit të efikasitetit. Disa prej këtyre kostove janë shpenzimet e personelit, reduktimi i kostove të mirëmbajtjes apo ulja e shpenzimeve të tjera që janë të domosdoshme për funksionimin e përditshëm të korporatës si shpenzimet e tjera operative, shpenzimet e zyrës, transportit, etj.

Duke pasur parasysh arsyet e paraqitura dhe të argumentuara në Propozimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale, KEK-u konsideron se nuk është në gjendje të arrijë efikasitetin të përcaktuar nga ZRRE gjatë shqyrtimit të saj. Zbatimi i saj në vitet e kaluara ka rezultuar me humbje financiare në kohën kur KEK-u është në gjendje të vështirë financiare si pasojë e reduktimit në të hyra dhe si pasojë e humbjeve të shkaktuara nga aksidenti.

### 3.4 Qasja e ZRrE-së në përshtatjen e kostovo të bartshme për shkak të ngjarjes së Jashtëzakonshme

Siç theksohet në dokumentin e Propozimit për të Hyrat e Lejuar Maksimale për Vitin e Tretë Relevantë të SHTE7 “KEK-u me date 10.06.2014, ka dërguar në ZRRE kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm si pasojë e shpërthimit të ndodhur në repartin e elektrolizës të Termocentralit Kosova A dhe me datë 26.06.2014 shkresën me dëmet e shkaktuara nga aksidenti. Komisioni profesional i KEK-ut ka përgatitur raportin final për dëmet e shkaktuara nga shpërthimi dhe KEK gjithashtu ka përgatitur dhe dërguar balancën e rishikuar të energjisë elektrike, me datë 24.06.2014, si pasojë e shpërthimit/aksidentit të ndodhur”.

Siç është theksuar në raportin konsultativ “ZRRE ka ripërcaktuar Kostot e Lejuara të Furnizimit me Thëngjill (LGSct), Kostot e bartshme (PSTCt) dhe Kostot e lëndëve të tjera djegëse (OTFct) të Gjeneratorit të Rregulluar që të përputhen me nivelin e ri të prodhimit prej 5,098 GWh në bazë pro-rata.”

Për shkak të vonesave për kthimin e njësive A4 të TC Kosova A në operim KEK-u gjatë vitit 2015 nuk do të mund të prodhojë energji elektrike sipas Balancës Vjetore të Energjisë për vitin 2015 (ku parashihet që njësia A4 do të jetë në operim me 25.01.2015). ZRrE është njoftuar për këtë vonesë në riparimin kapital të njësive A4 dhe A5 të TC Kosova A dhe KEK-u konsideron se ky ndryshim duhet të merret parasysh.

KEK-u kërkon edhe një here nga ZRRE që të pranojë të gjitha kostot e shkaktuara nga aksidenti (shpërthimi) i elektrolizës së TC Kosova A, në mënyrë që të mund të kryej të gjitha aktivitetet e domosdoshme të operimit, mirëmbajtjes dhe investimeve për rritjen e nivelit besueshmërisë së operimit të njësive gjeneruese, e më këtë edhe të prodhimit të energjisë elektrike.



### 3.9 MAR e Gjeneratorit të Rregulluar – Përmbledhje

Në tabelën 7 Përmbledhje e MAR e Gjeneratorit të Rregulluar është paraqitur një gabim teknik në vlerë (Të hyrat nga hiri TC B -1,944,410). Megjithatë vlera e saktë është -194,410 e cila vlerë është marr për bazë në llogaritjet për përcaktimin e Të Hyrave të Lejuar Maksimale për Gjeneratorin e rregulluar, por që ka mbetur në tabelë vlerë tjetër e cila duhet të rregullohet.

### 4 Ngarkesat e Gjeneratorit të Rregulluar

Llogaritja e ngarkesave (për kapacitet dhe energji) për vitin e tretë relevant është bërë sipas Balancës Vjetore të Energjisë për vitin 2015 ( parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga KEK ), me prodhimin e parashikuar të energjisë elektrike 5,289,802 MWh.

Pasi që remontet kapitale nuk janë realizuar sipas planit (të dërguar në nëntor 2014) dhe KEK-u ka dërguar planin e rishikuar të remonteve (A3 parashihet të jetë në operim me 11 mars 2015, ndërsa A5 me 18 prill 2015) tek ZRrE dhe ky ndryshim do të ndikojë që KEK-u të mos mund të realizojë të Hyrat e Lejuara Maksimale (rishikimi i ri – A3 parashihet të jetë në operim me 30 mars 2015, ndërsa A5 me 10 maj 2015). Duke pasur parasysh planin e rishikuar KEK-u nuk do të mund të prodhojë më shumë se 5,100,000 MWh.

KEK-u konsideron se ZRrE duhet të merr parasysh planin e ri për prodhimin e energjisë elektrike, ashtu që KEK-u të mund të realizojë të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2015. Në rast se ZRrE nuk e merr parasysh këtë ndryshim të balancës vjetore të energjisë, atëherë Gjeneratori i Rregulluar rrezikohet të mos mbulojë të hyrat e lejuara gjatë vitit 2015.



## 6.2 Rregullimi sekondar

KEK-u ka paraqitur në propozimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale kërkesën për rregullimin sekondar. Më vonë është dërguar vlerësimi financiar dhe teknik, në ZRrE (24 dhjetor 2014), për realizimin e rregullimit sekondar si shërbim ndihmës për KOSTT-in. Nëse nuk realizohen investimet e përcaktuara për realizimin e rezervës sekondare, atëherë KEK-u nuk do të jetë në gjendje të ofrojë rezervën sekondare për KOSTT-in. Prandaj, ZRrE duhet të marrë parasysh edhe investimet e nevojshme në mënyrë që KEK të jetë i gatshëm të ofrojë këtë shërbim në një të ardhme të afërt.